



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr. 184/2014

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Ferit Osmani kryesues, Rafet Haxhaj dhe Xhevdet Abazi anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e Lëvizjes Vetëvendosje (LVV), paraqitur kundër subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), për shkak të shfrytëzimit të resurseve publike për zhvillimin e fushatës zgjedhore për Zgjedhjet e Parakohshme Parlamentare, në seancën e panelit të mbajtur me 08.06.2014, mori këtë:

VENDIM

Refuzohet si e pabazuar ankesa e Lëvizjes Vetëvendosje (LVV)

Arsyetim

PZAP-i, me datën 05.06.2014 ka pranuar një ankesë nga LVV-ja në të cilën theksohet se me datën 05.06.2014 subjekti politik PDK ka sponsorizuar emetimin e videoklipit promovues për fushatë zgjedhore ku në këtë klip sipas parashtruesit të ankesës shihet qartë se subjekti politik PDK ka shfrytëzuar resurset publike për të zhvilluar fushatën zgjedhore ku kryetari i PDK-së Hashim Thaçi nga oborri i Qeverisë së Republikës së Kosovës ju drejtohet votuesve duke i fuar votuesit për të votuar subjektin politik PDK dhe numrin 58. Me këtë rast parashtruesi i ankesës thekson se subjekti politik PDK ka shfrytëzuar resurset publike në mbështetje të PDK-së e që sipas parashtruesit të ankesës këto veprime janë në kundërshtim me nenin 35.1 të LZP-së dhe nenit 6.2 të Rregullave Zgjedhore 11/2013 të KQZ-së. Andaj si dëshmi ka bashkangjitur videoklipin e incizuar në CD të marrë nga faqja zyrtare e Hashim Thaçit në video arkivën YouTube.

PZAP-i, në kuptim të nenit 4 paragrafi 3 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, e informoi subjektin politik PDK për ankesën që është bërë ndaj saj dhe ka kërkuar që të përgjigjet ndaj ankesës në fjalë deri më datë 06.06.2014 deri në ora 17:00

PZAP-i, pranoi përgjigjen e kërkuar nga subjekti politik PDK, në të cilën përgjigje theksohet se nga spoti në fjalë nuk ka asnjë dëshmi që kryetari i PDK-së Hashim Thaçi dhe aktivistët e simpatizantët e PDK-së në këtë spot paraqiten nga hapësirat dhe resurset publike ashtu siç pretendohet në ankesë, por se ata në këtë spot paraqiten nga sheshi “Skënderbeu” dhe jo nga oborri i Qeverisë së Republikës së Kosovës.

PZAP-i, pasi që shqyrtoi dhe analizoi shkresat e lëndës gjeti se:

ankesa është e pabazuar

PZAP-i, konstatoi se pretendimet ankimore të LVV-së se kryetari i PDK-së dhe njëkohësisht kryeministri i Kosovës Hashim Thaçi, gjatë fushatës zgjedhore ka shfrytëzuar resurset publike janë të pabazuara pasi që nga video incizimi i ofruar si dëshmi nga pala ankuese PZAP-i për asnjë moment nuk ka arritur që ta vërtetoj se këto veprime janë zhvilluar brenda hapësirës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, andaj PZAP-i në mungesë të provave dhe dëshmive konkrete dhe bindëse për pretendimet e paraqitura në ankesë konstaton se ankesa në fjalë është e pa bazuar dhe e pa argumentuar, andaj në kuptim të nenit 118 paragrafi 1 të LZP-së, lidhur me ankesën e lart përmendur vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

Anr. 184/2014 më datën 08.06.2014.

Kryesuesi i Panelit
Ferit Osmani



PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Andaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se gjoba e përfshirë është më e lartë sesa pesëmijë (5.000) Euro ose në rast se çështja prek një të drejtë themelore.*